# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-443325**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Vendimi për ish-krerët e UÇK/ Rutte: KFOR-i është aty, pavarësisht ç’mund të ndodhë këtë javë në Koso vë |
| ADRESA | `https://dosja.al/aktualitet/rutte-kfor-i-eshte-aty-pavaresisht-cmund-te-ndodhe-kete-jave-ne-kosov-i514092` |
| BURIMI | dosja.al |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 14 shtator 2026, 13:54:53 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 14 shtator 2026, 13:49:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `eba751f01eca80f1624988236599391d7f3ec172fcd626ac95e7df643fa470c9` |
| TEKSTI | `efa656037bfb5341be544ac7c175db48b2e9a378bd79650877bd9b8219fc2a44` |
| PAMJA | `2189fd1bd094ec39c2590a731aa31d1d2e2e7dde8973a281d87d316bf027e726` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `5760588c499e5f38892d5ddb2cb4b8b5d3a0a425a8ced3e4f75b5ffaa6a228d5` |
| E MËPARSHMJA | `cfd7462813a9b7aeb56c0cc565c5b53a074ec47e34a01860a2361f8a16a8618b` |
| RRËNJA MERKLE | `e0b9829abbee6aeaf0cbfff89c7cd5e0dcc89e0fb08f67fff94e9a06c82fe2c5` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/5760588c499e5f38892d5ddb2cb4b8b5d3a0a425a8ced3e4f75b5ffaa6a228d5`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

LIVE UPDATES ↘

1 ORE ME PARE
"Në epiqendër të takimeve ishte narkoshteti"/ Berisha pas kthimit në SHBA: Trump denoncoi rrezikun komunist dhe rrezikun e drogës, mbi të cilat qëndron regjimi i Ramës!

5 ORE ME PARE
Protestë te Zogu i Zi/ Shoqërohen 10 qytetarë nga policia, disa prej tyre dhunohen me grushta

5 ORE ME PARE
Nis viti i ri shkollor në sistemin parauniversitar / Rënie e numri të nxënësve, trafik i rënduar dhe alarm i rremë për bombë

21 ORE ME PARE
Dita e 106-të e protestës/ Qytetarët zbresin sërish në shesh, kërkohet dorëheqja e kryeministrit Rama: Ju erdhi fundi!

Politike

# Vendimi për ish-krerët e UÇK/ Rutte: KFOR-i është aty, pavarësisht ç'mund të ndodhë këtë javë në Kosovë

Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë do të shpallin më 16 shtator aktgjykimin ndaj ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, ish-kryeparlamentarëve Jakup Krasniqi dhe Kadri Veseli dhe ish-deputetit Rexhep Selimi, në rastin për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.

dosja
14 Shtator 2026, 15:49
Nga G.M



Shefi i NATO-s, Mark Rutte.

**KOSOVË-** Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, tha se përkushtimi i Aleancës për ruajtjen e paqes dhe sigurisë në Kosovë do të mbetet i pandryshuar, pavarësisht zhvillimeve të mundshme lidhur me aktgjykimin ndaj katër ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë do të shpallin më 16 shtator aktgjykimin ndaj ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, ish-kryeparlamentarëve Jakup Krasniqi dhe Kadri Veseli dhe ish-deputetit Rexhep Selimi, në rastin për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Të katërt janë deklaruar të pafajshëm për dhjetë pikat e aktakuzës.

Sipas Ruttes, KFOR-i është në aty, në Kosovë, për të siguruar që NATO-ja të kontribuojë në stabilitet dhe paqe, ndërsa misioni paqeruajtës i Aleancës, sipas tij, ka kontribuar për më shumë se dy dekada në krijimin e një mjedisi të sigurt dhe të qëndrueshëm në Kosovë.

*"Kjo vlen edhe sot, pavarësisht se çfarë lajmesh mund të vijnë këtë javë ose në periudhën e ardhshme, por edhe sa i përket zotimit afatgjatë për paqe dhe siguri në Kosovë"*, tha Rutte në një konferencë për media në selinë e NATO-s në Bruksel më 14 shtator, kur u pyet nëse është i shqetësuar për trazira të dhunshme të mundshme në Kosovë dhe rajon si rezultat i vendimit, pavarësisht se si do të jetë ai.

Shefi i NATO-s tha se aleanca ushtarake perëndimore do të vazhdojë të vlerësojë përbërjen dhe vendosjen e trupave të KFOR-it, për të siguruar që misioni të përshtatet në mënyrë adekuate me situatën e sigurisë në Kosovë. Ai theksoi po ashtu se zhvillimet në Kosovë ndikojnë edhe në rajonin më të gjerë.

Deklaratat e shefit të NATO-s vijnë disa orë pasi Ambasada amerikane në Prishtinë u bëri thirrje shtetasve amerikanë që të shmangin lëvizjet në afërsi të vendeve, ku siç tha, janë paralajmëruar protesta më 16 shtator.

editoriale

Irena Beqiraj
Fashizmi nuk duhet kërkuar tek revolta e protestuesve por në Kuvend!

Meri Lika
Plaçkaxhiu

Në vëmendje

POLITIKE 14 SHTATOR 2026, 14:44
A do mbushet bregdeti i Semanit me parqe foto voltaike? Subashi i Fierit hap 5 tendera për dhënie me qira të 391 mijë m2 tokë

AKTUALITET 14 SHTATOR 2026, 10:49
SKANDAL/ Policia dhunon protestuesit, momenti kur efektivi i 'Shqiponjave' i gjuan me gusht në bark

Ambasada tha se disa organizata po planifikojnë demonstrata të mëdha më 16 shtator në qendër të Prishtinës dhe qytete të tjera të mëdha të Kosovës.

*"Këto demonstrata mund të shkaktojnë grumbullime të mëdha njerëzish, mbyllje të rrugëve dhe ndërprerje në trafik"*, tha Ambasada duke udhëzuar shtetasit amerikanë që të kufizojnë lëvizjet në këto zona.

Shpallja e aktgjykimit në Hagë vjen katër ditë pasi në Prishtinë mijëra persona morën pjesë në "Marshin për Liri", ku pjesëmarrësit kërkuan që vendimi të jetë i drejtë dhe paanshëm.

Zyra e Prokurorit të Specializuar në Hagë pretendon se katër ish-eprorët e UÇK-së mbajnë përgjegjësi penale për krime të kryera në Kosovë dhe në veri të Shqipërisë gjatë periudhës së luftës. Mesazhe nga Prishtina para vendimit të Hagës për ish-krerët e UÇK-së

Aktakuza ndaj tyre përfshin gjashtë pika për krime kundër njerëzimit dhe katër për krime lufte dhe Prokuroria ka kërkuar nga 45 vjet burgim për secilin të akuzuar. Të katër ish-krerët e UÇK-së u arrestuan në nëntor 2020 dhe u transferuan në qendrën e paraburgimit të Dhomave të Specializuara në Hagë. Gjykimi nisi më 3 prill 2023.

Aktgjykimi i 16 shtatorit pritet të jetë një prej vendimeve më të rëndësishme të Dhomave të Specializuara, të krijuara në vitin 2015 për gjykimin e rasteve që lidhen me pretendime për krime të kryera nga pjesëtarë të UÇK-së gjatë dhe pas luftës së viteve 1998-1999./**REL**

mark rutte kosova nato

## Sondazh

Poll

Politike

14 Shtator 2026, 14:35

# Pagat e magjistratëve/ Braçe i ashpër me KLGJ dhe KLP: Në thesarin e shtetit nuk fut dorën kushdo

Erion Braçe TIRANË- Deputeti i Partisë Socialiste, Erion Braçe, duke folur në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave vijoi ...

### Ngërçi politik në Kosovë/ Hasani: Kuvendi është konstituuar në shkelje të Kushtetutës

Politike

14 Shtator 2026, 15:30

### "Mund t'i kallëzojmë"/ Braçe kritika të

AKTUALITET 14 SHTATOR 2026, 07:31

### Vajza e saj 10 muajshe ishte me temperaturë të lartë/ Gazetarja rrëfen eksperiencën në Pediatrinë e QSUT-së: Prindërit përballen me arrogancë dhe poshtërim

## më të klikuarat

**Vajza e saj 10 muajshe ishte me temperaturë të lartë/ Gazetarja rrëfen eksperiencën në Pediatrinë e QSUT-së: Prindërit përballen me arrogancë dhe poshtërim**

**Takimet për Reformën Territoriale/ Rama në Berat: Çfarë lidhje ka distanca? Ndryshon vetëm drejtimi vendor**

**Tension te Zogu i Zi/ Protestuesit zhvillojnë tubim në ditën e parë të shkollës, shoqërohen disa prej tyre (VIDEO)**

**SKANDAL/ Policia dhunon protestuesit, momenti kur efektivi i 'Shqiponjave' i gjuan me gusht në bark**

## insights

Ola Xama

**Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen**

Idriz Konjari

**Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?**

Bledian Koka

**Pse Erion Veliaj e "shkarkoi" sot Edi Ramen?**

Fjola Graçi

**REPUBLIKA E TRUPROJAVE/ Nga tokat te klubet VIP: Rrjoll, Zvërnec, Sarandë e Ksamil nën hijen e "burrave të zinj"**

## Moti

Powered by tomorrow.io

ashpra ndaj KLGJ dhe KLP për vendimet për pagat: Të kërkojnë falje se morën kompetencat e Kuvendit(VIDEO)

Politike

14 Shtator 2026, 14:30

---

Ilir Meta del nga kafazi/ Apeli i GJKKO pranon kërkesën: Gjatë seancave do qëndrojë krah avokatit

Politike

14 Shtator 2026, 14:59

---

A do mbushet bregdeti i Semanit me parqe foto voltaike? Subashi i Fierit hap 5 tendera për dhënie me qira të 391 mijë m2 tokë

Politike

14 Shtator 2026, 14:44

---

Politike

14 Shtator 2026, 14:15

## Gjyqi ndaj ish-krerëve të UÇK-së/ Verdikti shpallet më 16 shtator, ja kush janë gjyqtarët që do të vendosin për fatin e tyre

Foto ilustruse HAGA- Gjyqi ndaj ish-krerëve të UÇK-së do të zhvillohet në Hagë më 16 shtator. Seanca gj...

---

Pasuritë e sekuestruara/ Deputeti Gjoni: Shkojnë sërish në duart e pronarëve. Kreu i AAPK: Nuk ka përfitues të tillë, përdoren për nevoja të shtresave vulnerabël

Politike

14 Shtator 2026, 13:50

---

"A flet dot një gjykatës kështu?"/ Rama sulmon sërish gjyqtarët për pagat: Hata më vete për nga shkalla rrëqethëse e paditurisë

Politike

14 Shtator 2026, 13:11

### Berisha: Trump denoncoi rrezikun komunist dhe rrezikun e drogës, mbi të cilat qëndron regjimi i Ramës!

**Politike**

14 Shtator 2026, 13:01

### "Shqipëria është kthyer në parcelë eksperimentale të Sorosit"/ Berisha: Në SHBA shprehëm shqetësimin tonë për përdorimin e drejtësisë si armë politike nga Edi Rama!

**Politike**

14 Shtator 2026, 12:50

**MË SHUMË**




## Braçe kritika të ashpra ndaj KLGJ dhe KLP për vendimet për pagat: Të kërkojnë falje


Braçe kritika të ashpra ndaj KLGJ dhe KLP për vendimet për pagat: Të kërkojnë falje


Berisha:Trump denoncoi rrezikun komunist dhe rrezikun e drogës, mbi të cilat qëndron regjimi i Ramës


Berisha: Në SHBA shprehëm shqetësimin tonë për përdorimin e drejtësisë si armë politike nga Edi Rama


Berisha: Denoncuam farsën elektorale, sekretari Rubio nuk e uroi Ramën për zgjedhjet!

Shiko video te tjera

KTHEHU NE KRYE

Dosja.al është një iniciativë gazetarësh të rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta, ka media në shërbim të partive apo biznesit, por ka edhe të pavarura, që kanë zgjedhur rrugën më të vështirë, por më të ndershme dhe më të sigurtë për të qenë të besueshëm. Dosja.al do të jetë gjithmonë e pavarur, e vërtetë, në krah të interesit publik.

Telefon/Whatsapp: +355 68 2676 444
Email: [email protected]

KONTAKT PRIVACY POLICY COOKIES

MUNDESUAR NGA Mediadesk

AKTUALITET
POLITIKE
EKONOMI
BOTA
SPORT
ART&ARGËTIM
INSIGHTS
EDITORIAL

**Drejtor: Enton Abilekaj**

**Kryeredaktor: Izmir Akulli**

**Gazetarë:**
Esmeralda Doçi
Emanuela Dida
Elisa Karaj
Dorotea Simoni

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.